

# Albana Azizi: Eksperienca ime në Eurovizion..

Edhe pse për publikun shqiptar është një këngëtare e re, emri i Albanës do të zërë vend shpejt në tregun muzikor shqiptar sepse tashmë, ajo e ka treguar që është e talentuar. Albana ka realizuar këngë, klipe dhe së fundi ka publikuar edhe albumin e saj të parë me titull "Si herën e parë". Por jo vetëm kaq... Albana ishte konkruuese në Eurovizion dhe megjithëse nuk arriti ta përfaqësonte Zvicrën, e arriti suksesin e këngës. Kështu, vajza e talentuar do të vazhdojë të mbajë lart emrin e saj dhe të shqiptarëve, njëkohësisht...



**- Albana, prezantimi që do t'i bëje vetes për publikun shqiptar...**

- Kam lindur, jam rritur dhe jetoj në Bërn të Zvicrës. Kam kryer shkollën e mesme të Stomatologjisë, aktualisht, po ndjek mësimet për Kanto në Konservatorin e Bernit dhe punoj me një orar të shkurtuar, si asistente e stomatologut në një klinikë private në Bern.

**- Si i kujton fillimet e tua?**

- (Buzëqesh) Që nga mosha 6 vjeçare kam ndjekur mësimet për piano në shkollën e muzikës në Koeniz-Bern. Aty, mësuesja e muzikës vuri re talentin tim edhe për këndim. Kam marrë pjesë në koncerte të ndryshme me shkollën e muzikës, ku edhe jam përkrahur nga shkolla. Pastaj kam kënduar me band-grupin tim muzikor "BlindeMelons" dy vjet, por më pas u ndamë dhe kam kënduar vetë, kuptohet, në gjuhën gjermane dhe angleze, për manifestime të ndryshme për zvicranët dhe të tjerët.

**- Deri tani, ke realizuar disa këngë dhe klipe, ndërkohë që ke nxjerrë edhe albumin tënd të parë me titull "Si herën e parë"....**

- Kënga ime e parë është realizuar në Shkup, po atëherë kam pasur emër artistik dhe të gjithë më kanë njohur si Thaila. Shumë fansa më kanë kërkuar të dal me emrin tim të vërtetë, Albana Azizi dhe familja ime ka qenë dakord. Kam realizuar dhe disa këngë dhe dy klipe në Kosovë, ndërsa për albumin, kam bashkëpunuar me Top Channel, Dorian Gjonin dhe të gjitha këngët janë të Top Channel. Pas një viti pune rreth këngëve që ishte pak e vëshirë të punohet se unë isha larg Shqipërisë, punët nuk shkonin ashtu siç duhet, por më në fund pas

një viti u realizua albumi im i parë dhe dy klipet. Kurse Shtëpia Discografike Super Sonic e ka marrë në menaxhim albumin tim, si dhe hedhjen e tij në treg.

**- Çfarë do të thoje për eksperiencën në Eurovizion?**

- Kënga "I Love it", që ishte konkruuese për Eurovizionin, është realizuar në Shqipëri dhe klipi në Zvicër, nga një kompani gjermane. Kënga është pritur shumë mirë e ka qenë favorite për çmim, por nuk pata fatin ta përfaqësoja Zvicrën, ndonëse kënga dëgjohet në të gjitha radiot zvicrane. Kësaj radhe nuk u plotësua ëndrra ime fëmijërore. Shumë gazeta zvicrane shkruajtën për mua në Shqipëri dhe Kosovë. Në Zvicër më krahasuan me një talent të njohur zvicran që tani është 50 vjeçar. Më pas, më mori në menaxhim për Zvicër Slavia Karlen dhe mora pjesë në shumë mbremje muzikore, ku publiku zvicran dhe të tjerë mbetën të kënaqur me mua.

**- Pse përfaqësove pikërisht Zvicrën?**

- Zvicra është vendlindja ime, por mua më rreh zemra shqipe dhe kam prejardhje shqiptare, ndaj me krenari e mbaj emrin tim Albana. Dua t'u tregoj zvicranëve dhe të tjerëve se edhe ne kemi kulturë e talent, që mund ta përfaqësojmë kombin kudo që jemi. Çdo shqiptar është ambasador i vendit të vet, pa marrë parasysh se në cilin shtet të botës jeton.

**- Mjafton edhe vetëm emri yt për të kuptuar që je shqiptare... Në ç'rast të ka penguar ky fakt?**

- Po, është e vërtetë që

më pengon emri, si për shembull, në Eurovizion më ka penguar emri, por përsëri, unë jam krenare për emrin tim.

**- Sa e sigurtë ndihesh në vetvete?**

- Kam siguri të plotë në vetvete, se nuk e filloj asnjë punë që nuk do t'i dal në krye.

**- U trembesh zhgënjimeve?**

- Po, u trembem zhgënjimeve, por me punën time dhe të menaxheres sime, do t'ia dal dhe kam dalë me suksese.

**- Bashkë me Hekuran Krasniqin keni realizuar duetin "Loçkë"...**

- Po, ishte një bashkëpunim i mirë. Kënga ishte hit në Kosovë!

**- ...Zakonisht, i zgjedh ti bashkëpunëtorët e tu?**

- Po, menaxherja në bashkëpunim me mua, i zgjedhim bashkëpunëtorët.

**- Si arrin ta kurorëzosh me sukses rrugën që ke nisur?**

- Karriera ime është në fillim, por me punë të palodhur, besoj se do t'ia dal. (Buzëqesh)

**- Të shohim shpesh të shoqëruar nga mami. Ç'rol luan familja në vendimet e tua?**

- Po, kudo që shkoj në koncerte dhe në çdo vend që është i lidhur me muzikën, jam e sho-

qëruar nga mami, që është gjithçka për mua. Për mua, familja ime, mami, babi, motra dhe vëllai, janë të shenjtë.

**- Çfarë ka mbetur akoma nën kujdesin e prindërve?**

- Unë jam e pavarur nga prindërit, kam të ardhurat e mia, por ende jetoj te prindërit. Mamin e kam menaxhere kryesore.

**- Në ç'moment të jetës e sheh veten plotësisht të pavaruar prej tyre?**

- Unë, që tani jam e pavarur, por jam shumë e lidhur me ta.

**- Mendon se artist lind apo bëhesh?**

- Mendoj se artist lind, por duhet edhe të punosh.

**- Përveç muzikës, ka një tjetër dashuri në jetën tënde?**

- Po, verën e ardhshme do të filloj studimet në Stomatologji. (Qesh)

**- Muzika është po aq e bukur sa edhe e vështirë. Ti vetë, ku e sheh të bukurën dhe ku të vështirën?**

- Po, muzika është e bukur, por është e vështirë kur një kompozitor nuk ar-

rin t'i plotësojë kërkesat që i kërkoj unë!

**- Ke lindur në Zvicër... Çfarë privilegjesh të dhuron Zvicra?**

- Po, kam lindur në Zvicër dhe jam shtetase zvicrane. Privilegjet janë se kam pasaportë zvicrane dhe për çështje të udhëtimit, nuk kam vështirësi. Që të kesh privilegje në Zvicër, duhet të punosh shumë, shumë.

**- Si kalon dita jote?**

- Që nga ora 6 e mëngjesit, kur zgjohem, shkoj në punë. I kam orët e caktuara kur shkoj në konservator e pastaj, kur kam kohë, shkoj në fitnes dhe fundjavave, në mbremje muzikore. Domethënë, nga ora 6 e mëngjesit e deri në 6 të darkës, jam me angazhime.

**- Ke mbaruar për Stomatologji, ndërkohë që merresh me muzikë. Në të ardhmen, kujt do t'i përkushtohesh më shumë?**

- Po, kam mbaruar për Stomatologji. Prioritet e kam Stomatologjinë, por as muzikën nuk do ta lë anash.

**- Çfarë do të të mërzhiste në marrëdhënie me të**

tjerët?

- Mungesa e sinqeritetit!  
- Cilat kanë qenë emocionet më të forta që ke provuar ndonjëherë?

- Paraqitja ime e parë në skenë.

**- Çfarë të "josh" nga Shqipëria?**

- Se flitet shqip dhe gjatë pushimeve të verës, e kam kaluar fëmijërinë në Shqipëri, më shumë sesa në Kosovë. (Buzëqesh)

**- Këngëtarët në Shqipëri dhe Kosovë kanë burim kryesor fitimi, koncertet. Funkcionon edhe me ty kështu?**

- Jo, burimin kryesor e kam nga profesioni im.

**- Çfarë mendon se u pëlqen më tepër meshkujve te ti?**

- Nuk e di... (Buzëqesh)

**- Nëse dashurinë do ta gjeje në Shqipëri, do të sakrifikoje për të duke qëndruar në përgjithmonë këtu?**

- Ende s'e kam përjetuar dhe nuk di si ta them...

**- Si do t'i rendisje gjërat e tua më të rëndësishme në jetë?**

- Familja, shkollimi dhe të arrij në piedestalet më të larta në skenat muzikore.

**- Si mund të qëndrohet në majë, sipas teje, mes kaq shumë këngësh e këngëtarësh?**

- Duhet shumë punë dhe kompozitori i duhur.

**- Ku dallojnë emocionet që përjeton kur këndon në Zvicër, nga ato kur këndon për publikun shqiptar?**

- Për mua, emocionet janë të njëjta, si kur këndoj për zvicranët, ashtu edhe për shqiptarët.

**- Pas albumit, me çfarë po merresh?**

- Sigurisht, deri verës do të realizoj një singël dhe klip, por është herët ta them se me kë do të bashkëpunoj.

**Stafi i GAZETËS "INTERVISTA"**

**BOTUES**

Artan KRISTO

**DREJTORE**

**K/REDAKTORE**

Blerina ÇIZMJA

**GAZETARË**

Valbona VUKULAJ

Alma BUCI

Fabjola KUBURI

Agj. Raimonda BUMI

**SEKTORI I JASHTËM**

Nevila KRISTO



**Pastiçeri DUKA**

Lagjja:  
"Luigj Gurakuqi",  
pranë Stadiumit  
ELBASAN

Cel: 0692095101